



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:051471
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05554769

E.nr.689//23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditores Q.A., të cilën e përfaqëson av Fatos Pira nga Vitia, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën shtesë për shpenzime të ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimet e procedurës, më datë 08.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.689/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditores.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.689/23, të datës 15.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditores, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën shtesës të ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimet e procedurës, në bazë të aktgjykimit 2020:051471, të datës 13.04.2021.

Megenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 20.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,152.92 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores.

Megenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.689/23, më datë 08.04.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi